



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS



Komiteti për Politikë e Financa

Nr.02/ 741

Datë: 30.12.2019

PROCESVERBAL

I mbledhjes së XI (njëmbëdhjetë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa

REND I DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -X- të KPF-së.
2. Shqyrtimi i përgjigjes nr.01/1399 datë: 22.11.2019 të parashtruar nga kryetari i Komunës, sipas shkresës përcjellëse të KPF-së nr.02/578 datë: 24.10.2019
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/654 datë:27.11.2019 për miratimin e Planit Komunal për Riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2020.
4. Shqyrtimi i kërkesës nr.13/68 datë: 05.12.2019 për miratimin e Planit Zhvillimor Institucional në Kujdesin Parësor Shëndetësor në Komunën e Malishevës 2020-2024.
5. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Komunal të Aksionarëve për periudhën Janar-Dhjetor 2019.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Shtabit Koordinues të ndihmave për zonat e prekura nga tërmeti në Republikën e Shqipërisë.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i planeve të Punës të Komiteteve dhe Komisioneve për vitin 2020.
 - Komiteti për Komunitete
 - Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
 - Komiteti për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, dhe Persona me Aftësi të Kufizuara.
 - Komiteti për Familje të dëshmorëve, invalid vetëranë si dhe të Martirëve të luftës së UÇK-së.
 - Komiteti për Diasporë.
 - Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Turizëm, Mbrojtje të Mjedisit dhe monitorim të projekteve publike.
 - Komiteti për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.
 - Komiteti për Barazi Gjinore
 - Komisioni Komunal i Aksionarëve.
9. Të ndryshme.

Mbledhja mbahet me datë: 18.12.2019, dhe filloi në ora: 10:20. Morën pjesë 5 anëtarët e komitetit, zyra për informim si dhe Osbe.

Rrahim Morina: Përshendetje për të gjithë. Këtë rend dite e kam planifiku për mbledhjen e njëmbëdhjetë sipas planit të veprimit të kuvendit. Materialin besoj e keni marrë, dhe përveq atij neve na kan ardhë edhe disa kërkesa tjera, një plan pune, peticion ng fshati Bellanicë si dhe

rregullorja për transparencë. Shumica e komiteteve nuk i kanë sjell planet e veprimit që të cilat janë në rend dite, unë hap debat për rendin e ditës.

Alban Krasniqi: Unë kisha propozu që planet e punës së komiteteve dhe komisioneve që nuk kanë ardhë të mos i fusim në debat. Por të shtyhen për mbledhjen e Janarit, pasi që edhe komisioni i aksionarëve është pjesë e kësaj unë kisha mundur me përgatit, por për shkak që nuk i kam të dhënat që i kam kërkuar nga administrata nuk kam mundur ta përgatis. Përveq komitetit për barazi gjinore të gjitha të tjerat të largohen nga rendi i ditës.

Rrahim Morina: Albani po kërkon që me u largu nga rendi i ditës komitetet që nuk i kanë sjell planet e punës, përveq komitetit për barazi gjinore por Alban a je që me hy në rend ditë këto kërkesat tjera që na kanë ardhë.

Alban Krasniqi: Po ato le të futën.

Rrahim Morina: Kush është për ? Për: 4 unanimitet.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Rrahim Morina: Kush e don fjalën për procesverbal, a keni dikush diqka kundër, a po kush është për ? Për: 4 unanimitet.

2. Shqyrtimi i përgjigjes nr. 01/1399 datë : 22.11.2019 të parashtruar nga Kryetari i komunës, sipas shkresës përcjellëse të KPF-së nr.02/654, datë: 24.10.2019.

Rrahim Morina: Në mbledhjen e kaluar kemi kërkuar sqarime shtesë, por nuk na kanë sjell asgjë, sipas rregullores gjeodezia është deshtë më dal në teren me shiku se kujt i takon. Ligjin e kam lexu, dhe aty thotë se këmbimi bëhet vetëm nëse është në mexhë ose nëse është interes i komunës, ne i kemi kërku palës edhe vendimin e gjykatës që ne pastaj të marrim vendim.

Alban Krasniqi: Kjo shkresë nuk i plotëson kriteret që janë të parapara në ligjin për dhënie në shfrytëzim, dhe as parimin, sidomos parimin që ajo pronë kërkohet me u këmbu dhe kjo bëhet me iniciativ të komunës dhe interesi është i përgjithshëm, sikurse në rastin e lumit. Këto elemente nuk janë dhe kjo landë duhet të votohet kundër.

Hashim Vrenci: Pajtohna me Albanin, nuk duhet të votohet kjo pikë, por të i kthehet mbrapa kryetarit dhe të sjell pastaj raport nga gjeodezia.

Rrahim Morina: Kjo lëndë i kthehet kryetarit përsëri, kush është për ? Për: 5 unanimitet.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/654 datë: 27.11.2019 për miratimin e Planit Komunal për Riintegrim e qëndrueshmë të personave të riatdhesuar 2019-2020.

Rrahim Morina: Për këtë pikë, zyrtarja Edona e ka sjell planin e zyrës së saj, për riintegrimin e qëndrueshmë të personave të riatdhesuar 2019-2020.

Alban Krasniqi: A është Edona këtu me na prezantu këtë plan, nëse jo vazhdojmë më pikat e tjera.

Rrahim Morina: Jo ajo nuk është këtu, po e thërras, dhe derisa ajo të vijë vazhdojmë më pikën e ardhshme.

4. Shqyrtimi i kërkesës nr.13/68 datë: 05.12.2019 për miratimin e Planit Zhvillimor Institucional në kujdesin Parësor Shëndetësor në Komunën e Malishevës 2020-2024.

Alban Krasniqi: E njëjta gjë vlen edhe për këtë drejtori nuk është në mbledhje, nuk mundemi me shqyrtu. Por unë kisha propozu që me mbajtë një mbledhje të veçantë bashkë me shumë plane tjera dhe me një prezantim më të thellë, sepse zakonisht kur po mbajmë mbledhje dhe po kemi shumë pika në rend ditë ne po mbesim mangët me sqarimet nga drejtorët.

Rrahim Morina: Edhe pika e katërtë u shty për janar me 5 vota për.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të komunës për vitin 2020.

Rrahim Morina: Ne planin e punës do të përfundojmë dhe ta paraqesim para kuvendit, a jeni që ta rekomandojmë për kuvend këtë pikë? Për: 5 unanimisht.

Rrahim Morina: Pasi që Edona erdhë, vazhdojmë me pikën që do ta paraqes, urdhëro Edona fjalën e keni.

Edona Krasniqi: Përshendetje, jam Edona Krasniqi ky është plani komunal për vitin 2019-2020, i cili duhet të kalojë në Kuvend për miratim, ne sëbashku me ministrin e punëve të brendshme me departamentin për riintegrim e kemi punuar këtë plan, si dhe bashkë me komisionin për riintegrim.

Alban Krasniqi: Pasi që e hasa disa herë, çka kuptojmë me grupet e cenushme

Edona Krasniqi: Janë ata njerëz të rikthyme, të cilët janë të pa strehë në gjendje të mjerushme.

Alban Krasniqi: A janë grupe të cenushme ata që kthehen, apo ata që i dëbojnë, dhe a kemi ndonjë informacion sa raste të tilla i kemi.

Edona Krasniqi: Në të dy format i quajmë grupe të cenushme. Nuk ka raste të tilla në komunën tonë.

Alban Krasniqi: Neve na intereson me pa se çka ka ky plan, sepse përveq fillimit i gjithë plani është me tabela deri në fund. Normalisht duhet me pas një hyrje, ku do të ishim bazu rreth këtij plani edhe pse si plan është plot volum duhet me pas të dhëna. Dhe ata pak raste me qenë të cekura këtu, edhe pse po thua që nuk ka por prapë se prapë neve na intereson me ditë se për çka po e ngrisim dorën në kuvend, me një prezantim të qartë nga ti. Ne duhet mu siguru a ka kosto, dhe cila është kosto e tij dhe nga mbulohet ajo, dmth janë disa infomata që neve na duhet përpara se me votu këtë plan.

Hashim Vrenezi: Planin po parashihet deri në vitin 2020, por gjatë gjithë shfletimit është e cekur 2019-2022, sepse planin bëhet para se me fillu viti i ardhshme, ndërsa këtu e keni parapa edhe vitin 2019 është mirë me lënë 2020-2022.

Edona Krasniqi: Arsya është se ne trajnimin e kemi pas në muajin shtator të këtij viti për këtë plan, dhe pastaj ministria na ka bërë presion që të votohet sa më shpejtë dhe ashtu të vendosen vitet. Kostoja e tij mbulohet nga ministria e punëve të brendshme.

Raimonda Krasniqi: Vetëm fleta e parë e thotë deri 2020, pastaj brenda planit figuron deri në vitin 2022. Por 2019 vetëm se shkoj dhe nuk ka kuptim me lënë ashtu.

Hashim Vrenezi: Ideja ime kishë me qenë që kur të takoheni për ta përgatit planin e punës të Kuvendit komunal, të futet një pikë edhe për këtë dikaster që ne ta dimë fushë veprimin e tij, si funksion dhe gjithqka tjetër duke na raportuar.

Edona Krasniqi: Ky plan është për persona me nevoja të veçanta, të cilët i kthejnë dhe që nuk kanë vende pune, ose që kanë ndonje sëmundje.

Alban Krasniqi: Unë të kisha propozu me hy edhe ti Edone me lexu më në detaje këtë plan sepse mua po më del shumë më i zgjeruar. Sepse ne kemi shumë probleme familje në gjendje të rëndë, gra të dhunuar e shumë probleme tjera.

Hashim Vrenezi: Ideja është me ksi plani a mundemi ne më përfitu diqka nga niveli qendror si komunë për këto kategori. A shkrun dikun që kosto financiare mbulohet nga ministria, sepse nëse mbulohen shpenzimet unë jam që ta shtym përpara këtë plan.

Edona Krasniqi: Ne e kemi një sistem të riintegritit që qasemi, kur arrin një person i tillë në airopor, ne shkojmë e vizitojmë dhe e shohim gjendjen e tij, nëse është rast i cenushëm e dërgojmë në qendrën për punë sociale. Po të gjitha janë të shkruara.

Rrahim Morina: Edona i merr këto kërkesa që i ceken. A jeni që ta rekomandojmë për kuvend këtë plan ? Për: 5 unanimisht.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Shtabit Koordinues të ndihmave për zonat e prekura nga tërmeti në Republikën e Shqipërisë.

Rrahim Morina: Materialin e keni marrë edhe për këtë pikë, të gjitha të dhënat dhe ata që kan ndihmuar për këtë çështje i keni në dokumentacion prandaj unë hap debat.

Hashim Vrenezi: Në komunën e Malishevës është bërë një punë e madhe për të ndihmuar popullin e Shqipërisë, por deshta me u ndërlidhë që raporti nuk i ka edhe aktivitetet e fshatarëve që kanë bërë aktivitete brenda fshatrave të tyre dhe ato ndihma nga vendet e tyre i kanë sjell këtu, kjo është një mangësi që e ka ky raport që ato vende nuk janë përfshi. Ndoshta arsya është që qytetarët nuk kanë qenë të informum, që me i sjell ato të dhëna dhe me u kompletu raporti.

Alban Krasniqi: Si sqarim, raporti është i plotë me ato aktivtitete që i kemi ditë dhe kemi marr informatë që janë bërë.

Hashim Vrenezi: Thjeshtë duhet ta dimë a është raport i komunës, a po i iniciativave të qytetarëve që kanë bërë aktivitetet. Nëse është i komunës nuk është deshtë më u përfshi fshatrat. E nëse është i përgjithshëm është deshtë me i pas të dhënat komplet.

Alban Krasniqi: Hashim, unë nuk kam mundur më shku në çdo fshat me marrë informata.

Hashim Vrenezi: Është i mangët sepse nuk janë fut të gjitha fshatrat.

Alban Krasniqi: Raporti është i plotë me të gjithë që janë identifikuar si raste dhe që kemi marrë informata për to. Të tjerat nuk kemi mundur me i pas, sepse unë në baza vullnetare e kam bërë përpilimin e raportit bashkë me Artanin dhe Halitin, ndoshta ka pas iniciativa të shumta që kanë dhënë kontribut por nuk kemi marrë informata.

Hashim Vrenezi: Nuk është problem, por iniciativa e atyre që janë në qeverisje duhet të dihet e po ashtu edhe e qytetarëve.

Rrahim Morina: Përmes webfaqeve dhe mjeteve të informimit është bërë informimi.

Valon Krasniqi: Ka raste të shumta besoj akoma që ndihmojnë popullin në Shqipëri që janë prekur nga tërmeti.

Raimonda Krasniqi: Unë kam mirënjohje të thellë për të gjithë ata që kanë ndihmuar. E kam pa kontributin dhe vullnetin e popujve sidomos të kosovarëve, shumica edhe pse kanë pas shpenzime dhe taksën e kanë paguar, ata prapë se prapë nuk kanë pranuar të regjistrohen si kontribut dhënës. Unë jam shumë mirënjohëse për shpirtëbardhësinë që kanë treguar.

Rrahim Morina: A po pajtohen që ta rekomandojmë për kuvend këtë raport ? Për: 5 unanimit.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i planeve të Punës të Komiteteve dhe Komisioneve për vitin 2020.

Rrahim Morina: Prej komiteteve vetëm materialin e komitetit për barazi gjinore e kemi, unë hap debat rreth tij.

Alban Krasniqi: Ne po e adresojmë për kuvend, pasi që disa asambleistë janë edhe anëtarët të atij komitetit, si dhe ndoshta kishë qenë mirë me ardhë edhe kryesuesja që me prezantim këtë plan.

Rrahim Morina: Kush është që ta rekomandojmë për kuvend? Për: 5 unanimit.

Rrahim Morina: Drejtori i hidroregjionit Njaziu, ka kërku një ndihmë financiare, hap debat për këtë kërkesë.

Alban Krasniqi: Më sa kam informacion unë, komuna ka fillu tashmë shpimet ekziston një marrëveshje mes hidroregjionit dhe komunës, besoj informacion mundesh me i kërku kryetarit një raport për realizimin e kësaj kërkesë, sepse së pak një shpime e dimë që ka ndodh dhe pastaj ne në kuvend e debatojmë, se a duhet ta financojmë.

Hashim Vrenezi: Unë kisha kërku edhe marrëveshjen e bashkëfinancimit me na sjell.

Muharrem Morina: Po marrëveshja ekziston dhe është dy vjeçare, komuna e ka.

Rrahim Morina: A jeni që ta rekomandojmë për kuvend, dhe prezent me qenë edhe drejtori i hidroregjionit Njaz Bytyqi. Kush është për ? Për: 5 unanimit.

Rrahim Morina: Kërkesa për ndërrim destinim 06-95, ku është cek se drejtorja për urbanizëm ka kërku me u votu, sepse është në përcaktim me hartat zonale. Edhe pse aty ka objekt ekzistues.

Hashim Vrenezi: Këta paskan kërku që gjithsesi me u votu kjo kërkesë, sepse është sipas hartave zonale. Le të veprohet njëjtë si në rastet tjera, të dërgohet në ministri.

Alban Krasniqi: Dërgone edhe këtë rast në ministri për këshillim paraprak, spjegone rastin se si është që është objekti i ndërtuar aty dhe pyeteni a kemi të drejtë me bë ndërrim destinim.

Rrahim Morina: Kush është që të dërgohet në ministri për këshillim paraprak kjo kërkesë. Për: 5 unanimisht.

Rrahim Morina: Kërkesa 06/98 për ndërrim destinim në Maxharrë nga Ibrahim dhe Hajdin Shehu, ata e kanë cek që e kanë për të ndërtuar një fabrikë.

Alban Krasniqi: Është mirë me pas një standard të njëjtë për të gjithë, në momentin që e ngrisim dorën ne duhet ta dimë a kemi të drejtë a po jo.

Rrahim Morina: Në rregull po i përcjellim të dyjat për ministri. Vazhdojmë me kërkesën tjetër, e cila është nga Lumturie Morina, çka po mendoni për këtë rast sa mjete me ia nda, dokumentacionin e ka të kompletuar që dëshmon se vuan nga një sëmundje e rëndë.

Hashim Vrenezi: Unë jam për me i nda mjete, por pastaj drejtorja e financave nuk po i realizon vendimet që po i marrim ne si komitet.

Alban Krasniqi: Unë jam që këto kërkesa kur të vinë, me ardhë edhe personi që e bën kërkesën ose ndonjë familjar i tij, sepse ne duhet të dimë se kujt po i ndajmë mjete për arsye se disa nuk po i njohim.

Rrahim Morina: Apo pajtoheni me i nda 950 euro, kush është për ? Për: 5 unanimisht.

Rrahim Morina: A kalojmë të peticioni i fshatit Bellanicë kundër një gurëthyesi.

Alban Krasniqi: Këtu e kemi një peticion, por nuk kemi asnjë informatë tjetër rreth gurëthyesit, unë mundem me i numëru asambleistët nga Bellanica dhe ata nuk na kanë sjell asnjë informatë ose dëshmi. Mendoj që duhet me i kërku kryetarit një dokument nëse ka lëshuar, ose edhe drejtorit të inspektoratit me pa se a ka informacione për këtë, e po ashtu edhe kryetarit të Bellanicës.

Hashim Vrenezi: Inspektorati le të sjell informacione me raport për këtë rast.

Rrahim Morina: Kush është që ta rekomandojmë për kuvend ? Për: 5 unanimisht.

Rrahim Morina: Kryetari i komisionit për hartimin e rregullores për transparencë Nebih Bibaj, e ka sjell draft-rregulloren për shqyrtim me ndryshimet që kanë dhënë si komision. Urdhëroni a e don dikush fjalën, a po e rekomandojmë për kuvend ? Për: 5 unanimisht.

Rrahim Morina: Është edhe një kërkesë për ndihmë nga Lulzim Krasniqi, këta janë një familje të gjithë të vërbër.

Hashim Vrenezi: Këtu po thotë që operimin e ka kry në sy, po që mjetet i duhen.

Rrahim Morina: A po pajtoheni të ia ndajmë 500 euro Lulzimit, kush është për ? Për: 4.

Rrahim Morina: Kërkesa e Agnesa Kastratit nga komiteti për barazi gjinore, ku kanë kërku që të futet një pikë e rendit të ditës ku diskutohet për barazinë gjinore. A keni diqka me shtu, a po e vendosim si pikë të rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme të kuvendit. Kush është për ? Për: 4 unanimisht.

Rrahim Morina: E kemi një ankesë nga kryetari i fshatit Balincë për mos realizimin e projektit. Si mendoni a e dërgojmë ne urbanizëm. Për: 4 unanimisht.

Një kërkesë është për lirim nga taksa, por ne nuk e kemi atë të drejtë që ta lirojmë askënd. E po ashtu e kam edhe një kërkesë e cila ka ardhë tash, nga fshati Astrazup ku kanë kërku mjete për të ndërtuar një odë, kush është për ? Për: 4 unanimisht.

Faleminderit për pjesëmarrje. Me kaq po e përmbylli mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora: 11:45.

Procesmbajtëse

Verë Linda Gashi



Kryesuesi i Kuvendit

Rrahim Morina

